

Escobari: Shpresojmë që Kurti në një moment ta plotësojë kërkesën evropiane dhe amerikane



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## SKANDALI I RADHËS I GËRVALLËS NDAJ BE-së NXIT REAGIMET E TË DËRGUARVE PERËNDIMORË



Ministria e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, në Forumin e Dubrovnikut, ka thënë se pa Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n, Bashkimi Evropian është një 'tigër prej letre' në aspektin e sigurisë, duke nxitur

reagimet e të dërguarve amerikanë dhe evropianë si dhe të opozitës. I dërguari amerikan, Gabriel Escobar, tha se, ndryshe nga ministria Gërvalla, mendon se "gjithçka pozitive që ka ndodhur në Ballkan

ka qenë kombinim i bashkëpunimit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara". Përfaqësues të opozitës e kritikuan Gërvallën, duke e cilësuar "të papërgjegjshme" deklaratën e saj për BE-në

**KONJUFCA: JEMI NË NJË BETEJË SHUMË TË RËNDËSISHME PËR ORIENTIMIN E SHTETIT. DUHET TA FITOJMË**



**VIT I BRISHTË PËR VRESHTARËT E KOSOVËS**



### OPINION

**A JEMI PARA "RISHIKIMIT TË HISTORISË" APO PËRBALLË TRADHTISË KOMBËTARE**

Milazim KRASNIQI



### AKTUALE



**OPOZITA MAQEDONASE NDËRPRET KONTAKTET ME PUSHTETIN**

**PKD-ja: NDËRHYRJA E QEVERISË NË POLICI NUK MUND TA HESHTË AFERËN KORRUPTIVE MARTIN BERISHAJ - NAGIP KRASNIQI**

### EKONOMI



**MURATI: TREMUJORI I DYTË I VITIT SHËNON DINAMIKË REKORDE TË INVESTIMEVE KAPITALE**

**FILLON ZBATIMI I PROJEKTIT PËR LAJMËRIMET NË SHTËPI PËR PENSIONISTË NË TË GJITHA KOMUNAT**

### SPORT

**DABIOAJ: TRANSFERI IM BËRI BUJË PËR SHKAK TË RIVALITETIT TË KLUBEVE**

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fac: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Pak ditë para samitit të NATO-s, Bideni shfaqet duke shijuar rrezet e diellit në plazh

UASHINGTON, 9 KORRIK - Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, u pa të shtunën në plazh pranë shtëpisë së tij në Delaware,

duke shijuar diellin me gruan e tij Jill dhe mbesën e tij 22-vjeçare Finnegan. Sipas "Daily Mail", presidenti amerikan dhe

familja e tij u relaksuan në shezlongë, nën syrin vigilent të shërbimeve sekrete. Në fakt, pjesa tjetër e turistëve duket se

nuk i kushtuan vëmendje rrethit presidencial dhe vazhduan ta shijonin ditën me diell.



## Opozita maqedonase ndërpret kontaktet me pushtetin

SHKUP, 9 KORRIK - Opozita maqedonase ka njoftuar ndërprerjen e të gjitha kontakteve me qeverinë e kryeministrit Dimitar Kovačevski sa iu përket ndryshimeve kushtetuese, por edhe çështjeve të tjera dhe se "tani e tutje do të fokusohet vetëm në kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare". Organet drejtuese të VMRO DPMNE-së, këtë javë, sipas kryetarit të saj, Hristijan Mickoski, kanë vendosur ndërprerjen e çdo kontakti me qeverinë, përveç atyre që kanë të bëjnë me zgjedhjet parlamentare në vjeshtë. "Nuk do të kemi asnjë komunikim me qeverinë. Këtë javë kemi pasur një seancë të Komitetit Ekzekutiv të partisë dhe

kemi marrë vendim unanim që si VMRO-DPMNE t'i ndërpresim të gjitha komunikimet zyrtare në nivel bilateral me përfaqësues nga qeveria. Ka vetëm një gjë, ajo është të ulemi dhe të pajtohemi për zgjedhjet, kur do të mbahen zgjedhjet, si do të zhvillohen zgjedhjet, në çfarë mënyre - me një qeveri teknike, pa një qeveri teknike, pra do të flasim vetëm për atë që është e lidhur me zgjedhjet", ka deklaruar Mickoski. Vendimi i VMRO DPMNE-së vjen në kohën kur partitë në pushtet po kërkojnë mbështetjen e opozitës për miratimin e ndryshimeve kushtetuese, të domosdoshme për vazhdimin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Ndryshimet duhet të bëhen për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e Kushtetutës si popull shtetformues, ashtu siç parashihet me atë që njihet si "propozim francez" për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Bullgarinë për identitetin dhe gjuhën maqedonase dhe aspektet historike. Ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, tha të dielën se vendimi i VMRO DPMNE-së dëshmon, sipas tij, se "partia opozitare as nuk dëshiron dhe as nuk synon të përballet ndonjëherë me ndonjë sfidë që ka të bëjë me shtetin, por se qëllim parësor ka marrjen e pushtetit". Osmani tha se partitë në pushtet



kanë plotësuar të gjitha kërkesat e opozitës, por "për VMRO-DPMNE-në rëndësi kanë vetëm autoriteti dhe pushteti".

## OKB-ja: 9 000 civilë kanë vdekur në luftën 500 ditore në Ukrainë



NJU-JORK, 9 KORRIK - Kombet e Bashkuara (OKB) kanë vënë në dukje një numër të madh të viktimave civile në luftën në Ukrainë e cila po vazhdon prej 500 ditësh. Më shumë se 9 000 civilë, përfshirë 500 fëmijë, kanë vdekur që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt 2022, tha misioni i OKB-së për të drejtat e njeriut

në Ukrainë. "Sot shënon një fazë të re të zezë në një luftë që vazhdon të shkaktojë humbje të tmerrshme në mesin e civilëve ukrainase", tha Noel Calhoun, ndihmësshefi i Misionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Ukrainë, në një deklaratë të lëshuar të premtën, në ditën e 500 që nga fillimi i luftës, më 24 shkurt 2022. Edhe pse këtë vit numri i

viktimave ishte mesatarisht më i ulët se në vitin 2022, ai filloi të rritet përsëri në maj dhe qershor, thanë vëzhguesit. Në një sulm me raketa në Kramatorsk, në lindje të Ukrainës, më 27 qershor, 13 civilë u vranë, duke përfshirë katër fëmijë. Larg vijës së frontit në Lviv, në perëndim, dhjetë njerëz u vranë në granatimet herët në

mëngjesin e së enjtes, në atë që kryebashkiaku e quajti sulmin më të madh në infrastrukturën civile që nga fillimi i pushtimit. Në atë sulm 42 persona u plagosën, duke përfshirë tre fëmijë, sipas një raporti të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Ukrainës të publikuar të premtën. UNESCO njoftoi se ky sulm ishte gjithashtu i pari në një

zonë të mbrojtur nga Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore dhe se në të u dëmtua një ndërtesë historike. Qytetet Buça, në veri të vendit, jo shumë larg Kievit, dhe Mariupol në juglindje, janë bërë simbole të sulmeve të vitit 2023, për të cilat Rusia akuzohet për krime lufte dhe gjenocid.


## Franca ndalon mjetet piroteknike për festën kombëtare, pas trazirave

Paris, 9 korrik - Franca ka ndaluar shitjen, posedimin dhe transportin e lëndëve piroteknike gjatë festimeve të ardhshme të Ditës së Bastiljes,

pas trazirave të shkaktuara nga vdekja e një adoleshenti që u qëllua për vdekje nga një oficer policie. Të dielën qeveria nxori një

dekret që ndalon "produktet piroteknike" për festimet më 14 korrik, Ditën Kombëtare të Francës. Masa vjen pasi protestat u

kthyen në trazira për vdekjen e adoleshentit 17-vjeçar Nahel M. me origjinë algjeriane. Më 27 qershor ai u vra nga policia gjatë një kontrolli trafiku.



# Escobari: Shpresojmë që Kurti në një moment ta plotësojë kërkesën evropiane dhe amerikane

**EPOKA ERE**

Faton DËMAKU

PRISHTINË, 9 KORRIK - I dërguari special i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se plani evropian për Kosovën është i mirë dhe se “nuk i përshtatet asnjërës palë” dhe se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, do “të humbasë mundësinë” nëse ai nuk pranon ta zbatojë atë.

Ai, gjithashtu, ka bërë me dije se masat ndëshkuese për Kosovën

për shkak të mospërfilljes së kërkesave të aleatëve perëndimorë nuk përfshijnë largimin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it, në një bisedë me gazetarët kroatë në Zagreb para se të nisej për në Forumin e Dubrovnikut, raporton agjencia Hina të shtunën, transmeton Beta.

Këto deklarata Escobari i bëri në kohën kur veriu i Kosovës po përballet me trazira.

Trazirat shpërthyen pasi kryetarët e zgjedhur shqiptarë të katër komunave me shumicë

serbe morën detyrën me asistencën e policisë pas zgjedhjeve lokale që u bojkotuan nga shumica e serbëve.

I dërguari amerikan tha se ka “indikacione pozitive” se Beogradi mund t'i pranojë kërkesat e BE-së për dalje nga kriza, por se nuk mund të thotë të njëjtën gjë për kryeministrin e Kosovës Kurti. “Ne shpresojmë që (Kurti) në një moment ta plotësojë kërkesën evropiane dhe amerikane”, tha Escobar.

I pyetur se çfarë pasojash mund të ketë kjo për Kosovën dhe nëse

njëra prej tyre do të ishte tërheqja e misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), Escobar tha se kjo mundësi “nuk është në tavolinë”. “Partneriteti ynë me Kosovën është partneritet me popullin kosovar, jo me një parti apo një figurë politike”, tha i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor.

Ai theksoi se pasojë e mospranimit të planit evropian është një mundësi e humbur. “Kjo nuk është një masë ndëshkuese. Është një mundësi e humbur. Kjo po i ndodh Kosovës

tani sepse nuk po koordinohet me partnerët e saj”, shtoi Escobar.

Serbia në vazhdimësi po kërkon formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në veri të Kosovës, e cila parashihet në Marrëveshjen e Brukselit për Normalizimin e Marrëdhënieve nga viti 2013.

Kosova po përpiqet ta pengojë atë asociacion që të ketë kompetenca ekzekutive, duke theksuar se nuk dëshiron diçka si Republika Srpska në Bosnjë-Hercegovinë në territorin e saj.



## Rama shkarkon ministrin e Brendshëm Bledi Çuçi, në vend të tij emëron Taulant Ballën

TIRANË, 9 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka shkarkuar nga detyra ministrin e Brendshëm Bledi Çuçi. Vendimi i kreut të qeverisë vjen tri ditë pasi në media u publikua një video, ku dukeshin disa persona që sulmonin me shkopinj bejsbolli dy burra dhe i kërcënonin me armë.

Ngjarja ndodhi në një lokal në fshatin Borizanë të Fushë-Krujës.

Pjesë e personave të dyshuar për dhunë ishin edhe djali dhe dy vëllezërit e deputetit të Partisë Socialiste, Rahman Rraja.

Pas ngjarjes, kur ende nuk ishte publikuar video, policia e Krujës njoftoi se kishte shoqëruar vëllezërit e deputetit dhe më pas i kishte lënë të lirë.

Pas publikimit të videos, ku dukeshin të afërmit e deputetit me armë dhe duke sulmuar dy qytetarë, policia i shpalli ata në kërkim.

Dy viktimat e sulmit janë Jashar dhe Bilbil Maja, ky i fundit ende në spital për shkak të plagëve të mëdha. Ata protestuan disa herë bashkë me banorë të zonës kundër aktivitetit të disa gurave, në pronësi të fisit Rraja, duke pretenduar se shpërthimet që kryeshin për të

nxjerrë gurë në Malin e Krujës duke dëmtuar banesat e tyre.

Banorët e Borizanës kanë deklaruar se kanë bërë të paktën 40 denoncime në policinë e Krujës kundër pronarëve të gurave, por kanë marrë kërcënime prej krerëve të policisë se do të arrestoheshin nëse do të tentonin ta ndalonin aktivitetin e grurorëve.

Pak orë pas këtyre denoncimeve të banorëve në mediet vendase, kryeministri Edi Rama njoftoi me anë të një postimi në “Twitter” për shkarkimin e ministrit të Brendshëm, Bledi Çuçi dhe për emërimin në vend të tij të Taulant Ballës, aktualisht kryetar i grupit të Partisë Socialiste.

Ky ndryshim në qeveri i dorëzohet të hënën presidentit Bajram Begaj për ta dekretuar. “Falënderoj ministrin Bledi Çuçi për punën e tij si gjithnjë korrekte edhe në këtë detyrë dhe uroj që ministri i ri i Punëve të Brendshme, Taulant Balla, të çojë më tej përpjekjen tonë të palëkundur shtetndërtuese në çdo drejtim”, ka shkruar Rama në “Twitter”.

Pas këtij vendimi reagoi kryetari i grupit të deputetëve të Partisë Demokratike, Gazmend Bardhi.



Ai akuzoi të sapoemëruarin në detyrën e ministrit të Brendshëm, Taulant Balla, për lidhje me krimin. “Akti i sotëm i Edi Ramës është shumëfish më i rëndë sesa vetë ngjarja që solli shkarkimin e merituar të ish-ministrit Çuçi! Dorëzimi i Ministrisë së Brendshme në duart e krimit të organizuar është kapitullim i shtetit!”, ka deklaruar Bardhi.

Në të njëjtën ditë me shkarkimin



e ministrit të Brendshëm dha dorëheqje deputeti i Partisë Socialiste, Rahman Rraja. Ai tha se ndihej i turpëruar nga djali i tij, të cilit i kërkoi të dorëzohet dhe u kërkoi falje qytetarëve të Krujës. Rahman Rraja ka qenë për dy mandate deputet i Partisë Socialiste dhe më herët edhe kryetar komune.

Për ngjarjen e rëndë policia ka ndaluar tetë persona dhe ka shpallur në kërkim 6 të tjerë.

Mes të kërkuarve janë edhe djali i ish-deputetit të PS-së dhe tre vëllezërit e tij.

Një prej tyre është pronar i gurorës kundër së cilës kanë protestuar banorët e Borizanës. Në zonën e Krujës kryejnë aktivitetin e tyre disa gurorë, por banorët kanë protestuar disa herë kundër atyre që janë në pronësi të familjes Rraja, pasi kanë shtrirë aktivitetin e tyre në një distancë të afërt me banesat.



# Skandali i radhës i Gërvallës ndaj BE-së nxit reagimet e të dërguarve perëndimorë

Ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, në Forumin e Dubrovnikut, ka thënë se pa Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n, Bashkimi Evropian është një 'tigër prej letre' në aspektin e sigurisë, duke nxitur reagimet e të dërguarve amerikanë dhe evropianë si dhe të opozitës. I dërguari amerikan, Gabriel Escobar, tha se, ndryshe nga ministrja Gërvalla, mendon se "gjithçka pozitive që ka ndodhur në Ballkan ka qenë kombinim i bashkëpunimit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara". Përfaqësues të opozitës e kritikuan Gërvallën, duke e cilësuar "të papërgjegjshme" deklaratën e saj për BE-në

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 9 KORRIK** - Ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë të shtunën se pa Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n, Bashkimi Evropian është një 'tigër prej letre' në aspektin e sigurisë, duke nxitur reagimet e të dërguarve amerikanë dhe evropianë si dhe të opozitës.

Gjatë një fjalimi në kuadër të Forumit të Dubrovnikut, ministrja Gërvalla tha se çështja thelbësore për sigurinë në Ballkanin Perëndimor është nëse BE-ja mund të garantojë siguri

dhe paqe në Evropë. "Vlerësimi im është që BE-ja nuk mundet. Sepse nuk është në gjendje dhe e aftë të ofrojë siguri. Arsyet janë të dukshme: nuk ka vullnet politik, ka shumë mospajtim në bllok dhe pa Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n, BE-ja është një 'tigër prej letre' në aspektin e sigurisë", ka thënë Gërvalla. Përgjatë fjalimit të saj ajo shtoi se Evropa nuk ka asnjë histori suksesi në përpjekjet për t'i parandaluar luftërat. "Ne kemi nevojë për një strategji të re dhe njerëz të rinj që përpiqen të gjejnë një mënyrë më të mirë. Ndryshe nga të tjerët, ne nuk po përpiqemi ta përdorim BE-në si arkë. Jemi më shumë për

vlera evropiane sesa për paratë evropiane", ka thënë ministrja Gërvalla.

**Escobari: Gjithçka pozitive që ka ndodhur në Ballkan është kombinim i bashkëpunimit BE-ShBA**

I dërguari amerikan Gabriel Escobar tha se ndryshe nga ministrja Gërvalla, mendon se "gjithçka pozitive që ka ndodhur në Ballkan ka qenë kombinim i bashkëpunimit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara".

Escobari tha se rajoni i Ballkanit

Perëndimor është ndarë në dy shtigje: njëri me shtetet në NATO që janë shumë më të qëndrueshme, kontribuuese në qëndrueshmërinë rajonale dhe të vendosura në rrugën drejt integritetit evropian, tjetri i atyre që po konsumojnë vëmendjen dhe burimet e të tjerëve në rajon teksa ngecin me sfidat e tyre".

Sipas tij, dallimet thelbësore janë se shtetet të cilat janë pjesë e NATO-s dhe që kanë përjetuar zhvillimet më të mëdha janë ato që kanë tejkaluar sfidat e rivaliteteve etnike. "Ato që vazhdojnë të kenë udhëheqje që besojnë se popullizmi, nacionalizmi e rivalitetet etnike janë rrugët përpara, janë ata që po përballen me shumë sfida".

**Lajçaku: BE-ja nuk është e përkryer, por është ëndërr e shteteve që trokasin në dyert e saj**

I dërguari evropian Miroslav Lajçak ka thënë se Bashkimi Evropian është larg të

qenit i përkryer, por "është më i miri që kemi. Është bashkimi më i suksesshëm i shteteve. Nuk ka një bashkim tjetër në këtë planet që ka ofruar qëndrueshmëri politike e ekonomike më të mirë. Mendoj se anëtarësimi në BE është një ëndërr e shteteve që janë duke trokitur në derën e bllokut", ka thënë ai.

Qeveria e Kosovës është kritikuar nga diplomacia perëndimore dhe është vënë në masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian për shkak të tensioneve në veriun e saj ku grupe protestuesish serbë dolën në rrugë duke kundërshtuar vendosjen në zyra komunale të kryetarëve shqiptarë të dalë nga zgjedhjet e 23 prillit, të bojkotuara nga partitë serbe.

Perëndimi kërkon uljen e tensioneve përmes një plani evropian që parashih pezullimin e operacioneve policore në veri, zhvendosjen e kryetarëve të komunave në zyra alternative dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme me pjesëmarrje të pakusht të serbëve të Kosovës.

## Konjufca: Jemi në një betejë shumë të rëndësishme për orientimin e shtetit. Duhet ta fitojmë

PRISHTINË, 9 KORRIK – Kryeparlamentari Glauk Konjufca thotë se shpejtësia e realizimit të premtimeve të Lëvizjes Vetëvendosje ndoshta “nuk është siç është pritur”. Konjufca tha në emisionin Prizma në T7 të shtunën se vendi ndodhet “në një betejë të rëndësishme”, e cila do të përcaktojë se “çfarë orientimi do të ketë shteti i Kosovës” dhe se ajo duhet të fitohet. “Si mazhorancë kemi dalë aty me

disa premtime para qytetarëve. Ndoshta shpejtësia e realizimit të atyre premtimeve nuk është siç është pritur, mirëpo mendoj se tash jemi në një betejë shumë të rëndësishme, bash në këtë moment kur po flasim, e ajo betejë duhet të fitohet. Kjo betejë me të vërtetë ka shumë rëndësi për çfarë orientimi do të ketë shteti i Kosovës. Kjo është betejë për karakterin e shtetit”, tha

Konjufca. Kryetari i Kuvendit përmendi luftimin e fenomeneve negative si korrupsioni e të tjera që, sipas tij, janë punë të cilët ai beson se qytetarët i shohin dhe i vlerësojnë. “Janë disa parametra që po tregojnë që qytetarët të cilët e kanë besuar këtë opsion politik përafërsisht në vitin 2021 janë, me pak ndryshime, aty-këtu, të njëjtit pothuajse”, tha Konjufca.



## PDK-ja: Ndërrhyrja e qeverisë në polici nuk mund të heshtë aferën korruptive Martin Berishaj - Nagip Krasniqi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 KORRIK – Koordinator i Departamentit për Drejtësi në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë të PDK-së, Përparim Gruda, në një konferencë për medie të dielën e ka quajtur ndërhyrje të pastër politike nga ana e qeverisë shkarkimin e shefit të Njësisë së Veçantë të Hetimeve, Shemsi Hazirit, njësi kjo që udhëhiqte hetimet ndaj ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj dhe ish-kryeshefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi. Gruda ka thënë se qeveria ka

për qëllim të parandalojë çfarëdo hetimi të zyrtarëve të tjerë qeveritarë dhe partiakë të partisë në pushtet, pas Martin Berishajt dhe Nagip Krasniqit, si dhe t'i dekurajojë dhe frikësojë të gjithë hetuesi e pavarur brenda policisë së Kosovës. “Shkarkimi i drejtorit të Njësisë së Veçantë të Hetimeve tregon se kjo qeveri dëshiron të mbrojë me çdo kusht njerëzit e saj që janë nën hetime për korrupsion, dhe këtë po e bën duke ndërhyrë në mënyrë të papranueshme në procesin e hetimit ndaj tyre. Ky shkarkim shpjegon arsyen dhe motivet e vërteta pse kryeministri Kurti dhe kjo qeveri sulmonte prokurorin e

shtetit me aq brutalitet pak ditë pas arrestimit të Nagip Krasniqit”, ka thënë Gruda. Ai ka shtuar se, para së gjithash, ky rast dëshmon edhe se premtimet për luftë kundër korrupsionit dhe reformim të drejtësisë kanë qenë një mashtrim për hesapet elektorale të partisë në pushtet dhe kurrë një qëllim i vërtetë. Gjithsesi, Gruda ka thënë se askush nuk do të mund heshtë aferën korruptive të Martin Berishajt dhe Nagip Krasniqit. “Po ashtu, i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë nga ndërhyrjet politike në organet që po zhvillojnë hetimet dhe t'i hapë rrugë zbardhjes së kësaj afere. Më

lejoni të jem i qartë për të gjithë, nuk ka forcë që mund të mbyllë dhe heshtë aferën korruptive të Martin Berishajt dhe Nagip Krasniqit. Qytetarët e Kosovës do ta marrin vesh herët apo vonë të vërtetën e këtij skandali korruptiv. Në fakt, ky nuk është rasti i parë që një zyrtar brenda policisë shkarkohet sepse ishte duke hetuar Martin Berishajn dhe Nagip Krasniqin. Muaj më parë ishte shkarkuar edhe Musli Salihu, drejtor i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, për të cilin rast kishin raportuar edhe mediet në Slloveni, ku Martin Berisha dyshohet për pastrim parash”, ka thënë ai.

Gruda i ka bërë thirrje prokurorisë së shtetit të angazhohet për të siguruar një hetim të pavarur dhe të paanshëm për aferën korruptive të Martin Berishajt dhe Nagip Krasniqit në mënyrë që e vërteta e plotë të zbardhet deri në fund. Ambasadori Berishaj është nën hetime për aktivitetin e tij të paligjshëm dhe korruptiv që përfshin të paktën katër shtete të Ballkanit: Kosovën, Serbinë, Malin e Zi, Kroacinë dhe Slloveninë, ndërkohë që ish-drejtori i KEK-ut, Nagip Krasniqi, ndodhet në paraburgim nën akuzën për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është shprehur në favor të mbajtjes së zgjedhjeve të reja dhe uljes së pranisë së njësive të posaçme të policisë në veri krahas vendosjes së sundimit të ligjit.

Ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka theksuar se çështja e papërbushur është “tërheqja e njëkohshme e kryetarëve të komunave dhe njerëzve që ndodhen përreth

ndërtesave të komunave”, duke iu referuar protestuesve serbë.

### Reagime në Kosovë pas fjalimit të ministres Gërvalla

Përfaqësues të opozitës në Kosovë kritikuan fjalimin e ministres Gërvalla duke e cilësuar “të papërgjegjshme”

deklaratën e saj për BE-në.

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se ishte e paimagjinueshme që Kosova të shfaqet në konferenca ndërkombëtare si kundërshtar e Perëndimit, duke e zëvendësuar Serbinë dhe autokracitë e Evropës Lindore në këtë rol. “Ka ndodhur një ndërrim i roleve: Kosova tash është kundërshtar dhe Serbia shihet si

partnere, sikurse ndodhi sot në Dubrovnik! Logjika e diplomacisë së çajtoveve e sheh sekretarin Blinken si naiv dhe BE-në si tigër prej letre!”, ka theksuar Hoxhaj. “Të mjerë dhe të rrezikshme” e ka cilësuar gjendjen diplomatike të Kosovës zëdhënësja e Lidhjes Demokratike, Sibel Halimi. Sekretari i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Muharrem Nitaj, shkroi se “më e pakta që do të duhej,

është një deklaratë e presidentes dhe kryeministrit ku do të sqaronin se ajo që ka thënë ministrja e Jashtme nuk është qëndrim zyrtar i Republikës së Kosovës”.

Opozita e ka kritikuar ashpër Qeverinë e Kosovës për dëmtim të marrëdhënieve me aleatët, duke paralajmëruar veprime për ta kundërshtuar qasjen e qeverisë ndaj krizës në veri të vendit.

# A jemi para 'Rishikimit të historisë' apo përballë tradhtisë kombëtare



Milazim KRASNIQI

Konflikti ndërmjet Albin Kurtit e Edi Ramës shkon shumë përtej profileve të tyre psikologjike dhe madje shumë përtej ngjarjeve të fundit. Ky konflikt në instancë të fundit ka të bëjë me krizën e thellë të qëndrimit ndaj kombit shqiptar, veçmas në Kosovë. Qëndrimi ndaj kombit shqiptar në Kosovë ka hyrë në një proces halucinant çrregullimi e deformimi. Përveç në përvjetorë për të vdekurit, në raste të tjera pothuajse kurrë nuk mund ta dëgjosh të përdoret sintagma kombi shqiptar, as nga politikanët, as nga akademikët, as nga opinionistët, as nga klerikët në Kosovë. Sintagma kombi shqiptar është futur nën embargo.

Në këtë rast shihen edhe pasojat e presionit fillestar neokolonialist, me të cilin aspironhej që deshqiptarizimi të përdorej për pajtim me serbët. Nga prezenca ndërkombëtare mendohej se duke krijuar një shoqëri multietnike, pa ngarkesa

nacionale, mund të arrihej më lehtë pajtimi. Por ndodhi që deshqiptarizimi u arrit në një masë të madhe, por jo edhe pajtimi. Vendin bosh të shqiptarizimit, e zuri stalinizmi shqiptar. Kësisoj, Kosova krahas deshqiptarizimit, u ristalinizua. Ndërsa, stalinizmi shqiptar e ka rritë konfliktualitetin edhe me serbët dhe me të gjithë të tjerët që ka përballë.

Duke mos e pasur asnjë ide se çka të bëjnë me veten e tyre në realitetet e reja jetësore, shqiptarët e Kosovës, të dominuar nga ideologjia dhe praktika staliniste, tashmë janë shumë nevrinë, nevrastenikë dhe paranojakë. Nuk e durojnë asnjë fjalë, asnjë këshillë, asnjë vërejtje. Madje as nga Bill Klintoni, çlirimtari i madh i Kosovës. Lëre pastaj ta durojnë ndonjë fjalë a veprim nga Edi Rama. Tashmë sulmet edhe ndaj Bashkimit Evropian janë sublimuar në shprehjen e famshme maoiste të Donika Gërvallës se Bashkimi Evropian

na qenka tigër prej letre. (Jam i bindur se as lideri kinez e as rus nuk e kanë këtë mendim për Bashkimin Evropian.) Natyrisht këtë riindoktrinim stalinist e ka ideuar dhe pompuar në mënyrë absolute personalisht Albin Kurti dhe "Lëvizja Vetëvendosje!" Fillimisht LV-ja e ka konsideruar prezencën ndërkombëtare në Kosovë si armiqësore. Mandej si armiqësorë i ka shikuar e trajtuar të gjithë kundërshtarët politikë në skenën politike të Kosovës. Meqë pas zgjedhjeve të vitit 2021, Kosova ka mbetur pa opozitë reale, sepse elektorati i dha Kurtit dhe LV-së pushtet absolut, mujsharia staliniste albiniane tashmë ka filluar që edhe Shqipërinë ta trajtojë si armiqësore, sepse stalinizmi pa armiq nuk funksionon. Bile marrëzia antiShqipëri ka mbërritur deri në atë pikë sa deputetë të LV-së, të kërkonin që shqiptarët e Kosovës ta bojkotonin bregdetin shqiptar.

Me një fjalë u ka humbur tërësisht orientimi në kohë e në hapësirë. Ky version i ri i stalinizmit, albistalinizëm, duke u konfrontuar me komunitetin euro-atlantik, me Shqipërinë dhe me opozitën, në thelb është bërë tërësisht antikombëtar. Pse? Sepse shqiptarizimi, si edhe atlantizmi, po u paraqitet si pengesë në synimin e instalimit të regjimit të terrorit, atij terrori që e patën eksperimentuar në kohën sa ishin në opozitë. Prandaj edhe sulmet ndaj Edi Ramës në fakt janë sulme për t'u distancuar atlantizmi dhe nga shqiptarizimi, që mishërohen me Shqipërinë. Kjo fare nuk do të thotë se Edi Rama domosdoshmërisht përfaqëson shqiptarizmin. Stalinistëve të LV-së u mjafton fakti që ai përfaqëson atlantizmin, për ta shikuar si tepër armiqësor. Pra, Edi Rama po përdoret vetëm si tabelë qitjeje, për ta vrarë përtej tij shqiptarizmin dhe atlantizmin, jo pse mban çorape të kuqe. Nëse vazhdon kjo çoroditje dhe

nëse bëhet triumfuese, në Kosovë mund të ketë këto versione të çrregullimit antishqiptar: 1. Armiqësia ndaj Shqipërisë do ta zëvendësojë armiqësinë ekzistuese ndaj Serbisë, ashtu që armiqësia ndaj Shqipërisë do të bëhet virulente, aktive, ndërsa armiqësia ndaj Serbisë do të mbetet indolente, pasive. 2. Gjeneratat e reja në Kosovë mund të bëhen antishqiptarë siç janë bërë maqedonasit ndaj bullgarizmit. 3. Mund të eksperimentohet që të formohet një komb tjetër, jo domosdoshmërisht kosovar, por një komb ideologjik, si koreano-veriorët. 4. Mund të kërkohet në në ardhmen bashkimi me Serbinë siç po kërkojnë një masë e madhe proserbe në Malin e Zi. 5. Do t'i rikthehen nacionalizmit burimor shqiptar dhe LV-në e Kurtin do ta shpallin tradhtar të kombit shqiptar. P.S. Unë besoj se kjo e fundit ka më shumë gjasë të ndodhë, bile në të ardhmen jo fort të largët. (9 korrik 2023)

## Ardian Shala edhe një mandat në krye të Degës së LDK-së në Suharekë

**SUHAREKË, 9 KORRIK** - Në kuadër të zgjedhjeve të brendshme në LDK, të dielën ka përfunduar zgjedhja e strukturave të reja të degës në Suharekë.

Në procesin e zgjedhjeve për Kuvendin X Zgjedhor në Suharekë ishin të angazhuar më shumë se 1 000 qytetarë, aktivistë dhe veprimtarë të Lidhjes Demokratike të

Kosovës, të cilët sot mbyllën këtë proces si dhe dr. Ardian Shalës ia besuan edhe një mandat 4-vjeçar. "Puna dhe përkushtimi për artikullimin dhe dhënien e alternativave për problemet dhe sfidat e jetës së përditshme si dhe kërkesave të strukturave tona në Suharekë bën që Ardian Shala ta marrë besimin edhe për mandatin e ardhshëm.

Kryetari Abdixhiku i falënderoi dhe shprehu mirënjohjen e tij ndaj secilit që ka marrë pjesë në procesin e brendshëm zgjedhor. Procesi zgjedhor në LDK, përveçse po dëshmon demokracinë si vlerë tonën në çdo hap, po shërben edhe si mobilizim i të gjithë anëtarësisë", ka njoftuar LDK-ja.



## Vit i brishtë për vreshtarët e Kosovës

PRISHTINË, 9 KORRIK - "Sot, sikur të ma jepnin nënshtrësinë e Zvicrës, do t'u thosha mbajeni, nuk më duhet, sepse unë i kam vreshtat e mia", kështu e përshkruan pasionin që ka për vreshtarinë Fatmir Pajzaiti nga Potoçani i Ulët i Rahovecit - pjesa perëndimore e Kosovës. Mëngjesi i 7 korrikut e gjeti atë duke i shikuar dëmet që ia shkaktoi një shi i rrëmbyeshëm që kishte rënë gjatë natës. Vitin e kaluar Fatmiri thotë se

ka shitur rreth 36 mijë kilogramë rrush të llojeve të ndryshme. Sivjet nuk beson se do të arrijë të vjelë as gjysmën e kësaj sasive. Njëjtë si vreshtat e tij, shirat kanë dëmtuar edhe vreshtat e tjera përreth. Disa punëtorë që ishin duke punuar në vreshtat e një kompanie të madhe të prodhimit të verës në Rahovec i thanë Radios Evropa e Lirë se, krahas motit të keq, vreshtat këtë vit i kanë dëmtuar edhe

sëmundjet e ndryshme. Ata thanë se po i spërkatnin hardhitë kundër sëmundjeve - disa prej të cilave, sipas tyre, janë shkaktuar nga moti i lig. "Sa më shumë shi, aq më shumë sëmundje për rrushin", u shpreh një prej punëtorëve. Sipas vreshtarëve, moti me shi dhe breshër i ka dëmtuar më shumë vreshtat e reja, që janë mbjellë në 3-4 vjetët e fundit. Një vresht me hardhi të reja zakonisht fillon prodhimin e rrushit në vitin e tretë. Por, këtë

vit, duket se shumë vreshta nuk do të prodhojnë fare rrush, pasi janë tharë. Vitet paraprake, kur moti në pranverë dhe në verë ka qenë më i mirë, vreshtarët kanë kontribuar që në Kosovë të prodhohen mbi 8 milionë litra verë. Mbi 7 milionë litra verë që prodhohen në Kosovë eksportohen jashtë vendit. Sipas një raporti të vitit 2017 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të

Kosovës, sipërfaqja me vreshta në Kosovë ka qenë rreth 9 000 hektarë në vitin 1988, ndërsa sot kultivohen mbi 3 100 hektarë, prej të cilëve 769 hektarë janë me rrush tryeze dhe rreth 2 300 hektarë me rrush për verë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rreth 75 % e vreshtave janë në pronësi të fermerëve, ndërsa pjesa tjetër - rreth 25 % - është në pronësi të kompanive prodhuese të verës.



## Murati: Tremujori i dytë i vitit shënon dinamikë rekorde të investimeve kapitale

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministri i Financave, Hekuran Murati, pas adresimit dhe rregullimit të shumë problemeve me projektet, kontratat e shpronësimit, sivjet ka nisur një dinamikë të re të investimeve kapitale nga organizatat buxhetore. Ai ka thënë se tremujori i dytë i vitit 2023 ka shënuar nivelin prej 110 milionë eurosh investime kapitale, që është niveli më i lartë i regjistruar. "Krahasuar me vitin paraprak, ka më se dyfishim të dinamikës, që pritet të shërbejë si impuls pozitiv edhe për rritjen e ekonomisë në TM2, më lart sesa në TM1, ku



rritja reale ishte 3.9 %. Një fenomen tjetër që vërehet nga grafiku është një shpenzim më i

lartë në kategorinë e kapitaleve në tremujorin 1 për disa prej viteve paraprake, por që është

botërisht e ditur se në muajt e dimrit kushtet atmosferike nuk mundësojnë kryerje të punëve. Kjo sqarohet me faktin se në ata tremujorë ka ndodhur pagesa e vonuar e faturave të vitit paraprak, gjë që ndikon negativisht edhe në likuiditetin e punëkryesve dhe në aktivitetin ekonomik në përgjithësi", ka shkruar Murati në "Facebook". Ai ka thënë se si qeveri ka qenë zotim i tyre që faturat do të paguheshin me kohë në mënyrë që të mos shkaktohen probleme për punëkryesit, dhe ndryshimi vërehet edhe në uljen drastike të faturave të

papaguara për më gjatë se 30 ditë. Kjo vërehet edhe në grafikun nëse shikohen TM1 në dy vitet e fundit, ku s'ka pasur fatura të prapambetura nga vitet paraprake. "Në nivelin komunal, fatkeqësisht, për disa komuna që janë ngarkuar me borxhe të papaguara si rezultat i keqmenaxhimit, ende vazhdon të jetë ky problem i vonesave në pagesën e faturave. Por si MFPT po bëjmë çmos që ta përmirësojmë situatën e ta rritim disiplinën fiskale ashtu që të mos ketë më probleme të tilla në të ardhmen", ka deklaruar ministri Murati.

## Fillon zbatimi i projektit për lajmërimet në shtëpi për pensionistë në të gjitha komunat

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministria e Financave ka njoftuar të shtunën se ka filluar angazhimin e ekipeve mobile me qëllim të lajmërimit të pensionistëve në të gjitha komunat e Kosovës. Nga ky shërbim thuhet se do të përfitojnë pensionistët që janë në dhe mbi moshën 80-vjeçare dhe ata që për shkaqe shëndetësore nuk mund të paraqiten fizikisht për vazhdimin e pagesës së pensionit pa marrë parasysh

moshën. "Ky shërbim ka filluar të zbatohet fillimisht në regionin e Prishtinës (komuna e Prishtinës, Fushë-Kosovës, Drenasit, Lipjanit, Podujevës, Obiliqit dhe Graçanicës), si pilot-projekt, nga muaji shkurt i këtij viti, duke qenë i kufizuar me moshën 85+. Ndërsa tani zgjerohet edhe në të gjitha komunat, si dhe përfshihen të gjithë pensionistët 80+ dhe secili pensionist që për shkaqe

shëndetësore nuk mund të paraqitet fizikisht", thuhet në komunikatën për medie të ministrisë. "Kërkesa mund të paraqitet individualisht nga pensionisti apo nga çdo preson tjetër që e paraqet në emër të pensionistit. Kërkesa duhet të paraqitet së paku 7 (shtatë) ditë para datës kur pensionisti duhet të lajmërohet fizikisht pranë zyrave të Departamentit të Pensioneve", bëhet me dije në njoftim.



# Kush është Alex Soros, 37-vjeçari që ka marrë në dorë perandorinë financiare të babait

Nga Gregory Zuckerman  
"Wall Street Journal"

George Soros, investitori legjendar, filantropi dhe objektivi i përhershëm i krahut të djathtë në SHBA, po ia dorëzon kontrollin e perandorisë së tij 25 miliardë dollarëshe djalit të tij më të vogël, Alexander Soros, një njeri i vetë-përshkruar si një mendimtar i qendrës së majtë, që u rrit me vetëdijen mbi pasurinë e madhe të familjes por që nuk mendohej se mund të ishte pasardhësi i mundshëm.

Në intervistën e parë që nga përzgjedhja e tij, 37-vjeçari thotë se synon të zgjerojë zbatimin e parimeve liberale të babait të tij. "Ne mendojmë njësoj mbi shumë gjëra" - thotë i riu Soros, teksa shton se përfaqon disa kauza të ndryshme nga i ati. Ato përfshijnë të drejtat e votës dhe abortit, si dhe barazinë gjinore. Ai planifikon të vazhdojë të përdorë pasurinë e familjes për të mbështetur politikanët amerikanë me prirje të majta. "Unë jam një njeri më politik se babai" - thotë Alex. Kohët e fundit ai u takua me zyrtarë të administratës Biden, udhëheqësin e shumicës në Senat, Chuck Schumer dhe disa krerë shtetesh, përfshirë presidentin e Brazilit Luiz Inácio Lula da Silva dhe kryeministrin e Kanadasë Justin Trudeau, për të mbrojtur çështjet që lidhen me themelimin e familjes.

Fondacionet e Shoqërisë së Hapur të Soros, të njohura shkurtimisht si OSF, financojnë rreth 1.5 miliardë dollarë në vit grupet që mbështesin të drejtat e njeriut në mbarë botën dhe që ndihmojnë në ndërtimin e demokracive. Por paratë e fondacionit shkojnë gjithashtu për universitetet dhe organizata të tjera arsimore.

Po ashtu fondacioni ka mbështetur fushatat zgjedhore të prokurorëve të qarkut dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit në SHBA që synojnë të ulin normat e burgosjeve dhe paragjykimet racore në sistemin e drejtësisë. Alex thotë se është i shqetësuar për mundësinë e rikthimit të Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, duke deklaruar se fondacionit do të luajë një rol të rëndësishëm në garën presidenciale të 2024-ës.

Disa analistë dyshuan nëse George Soros, aktualisht 92 vjeç, do të hiqte dorë nga roli i tij sa kohë që është ende gjallë. Madje në një intervistë dhënë disa vite më parë ai tha: "në parim nuk dua që fondacioni të drejtohej nga ndonjë prej fëmijëve të mi. Mendoj se ai duhet të menaxhohet nga dikush që është më i përshtatshmi për këtë post".

Për vite me radhë, njerëzit e afërt me George besonin se gjysmë-vëllai më i madh i Alex, Jonathan Soros, 52 vjeç, një avokat me përvojë financiare, ishte pasuesi i sigurt i miliardërit të famshëm. I gjatë dhe me një trup atletik, Jonathan luante shpesh tenis me të atin, punoi për një periudhë në fondacion dhe e stabilizoi atë gjatë kohërave të trazuara.

Pastaj ndodhi një përplasje midis të dyve dhe një ndryshim i qasjes. Alex arriti të fitojë besimin e babait të tij, duke qëndruar në krah të tij në udhëtimet që bënte në zyrat e organizatës nëpër botë. "Ai e ka fituar besimin tim" - konfirmoi George. Në dhjetor të vitit të kaluar, bordi i OSF zgjodhi Aleksin si kryetar të tij, duke zëvendësuar zyrtarisht të atin.

Alex Soros është i vetmi anëtar i familjes në komitetin e investimeve që mbikëqyr Menaxhimin e Fondacionit Soros, kompania që mbikëqyr paratë për fondacionin dhe familjen. Deri më tani puna e Alex në organizatën e familjes ka nxjerrë në pah një stil të menaxhimit kolegjal që ndryshon nga ai i babait të tij, thonë kolegët e tij.

Alex kujdeset për detajet që George në përgjithësi i injoronte. Ai mban një bllok të vogël gjatë takimeve, të cilat i mbush me shënime, që më pas ua ndan stafit. "Ai është një drejtues shumë praktik" - thotë Anthony Romero, drejtor ekzekutiv i Unionit Amerikan për Liritë Civile, që merr financime nga OSF.

Përzgjedhja e Alex, një fans i rrymës hip-hop dhe një tifoz i ekipit New York Jets të futbollit amerikan, dukej dikur e pamundur. Sepse Alex fliste me vështirësi në takime dhe ishte më i njohur për jetën e tij mondane. George Soros e ndërtoi pasurinë e tij në vitet 1970-1980 si një menaxher pionier i fondacioneve financiare.

Ai investoi shumë në tregjet globale të aksioneve, obligacioneve dhe valutës, bazuar në parashikimet e tij për ndryshimet ekonomike dhe politike. Soros investonte vetëm pasi kishte shqyrtuar një rrjet të gjerë informacioni, përfshirë të dhënat e klasifikuar të marra nga një rrjet kontaktesh të ngushta në politikë dhe biznes. Vetëm basti se vlera e paundit britanik në vitin 1992 do të binte në pikatë, i garantoi më shumë se 1 miliardë dollarë fitime. Ajo që e dallonte George ishte aftësia e tij për të ndryshuar drejtimin e investimeve thotë Stanley Druckenmiller, ish-shefi i investimeve në kompaninë e tij. Pas rënies së Murit të Berlinit në vitin 1989, aktiviteti filantropi i Soros u fokusua në mbështetjen e demokracive në ish-blokun sovjetik dhe gjetkë.



Në vitin 2004, ai u sulmua ashpër në SHBA, kur deklaroi se parandalimi i rizgjedhjes së presidentit George W. Bush ishte "fokusi kryesor" i jetës së tij.

Ai e mbështeti fushatën presidenciale të Barack Obamës në vitin 2008, teksa shkaktoi kritika të mëtejshme për mbështetjen e programeve të shkëmbimit të gjilpërave dhe legalizimit e marijuanës për përdorim mjekësor. George, që ka lindur në Hungari, e mbylli degën e fondacionit në këtë vend në vitin 2018 pasi u bë objektivi i sulmeve të kryeministrit Victor Orban.

Që nga ajo kohë kritikuesit janë shtuar. Muajin e kaluar, Elon Musk shkroi në Twitter se George Soros "më kujton Magneto-n", një personazh i librit komik të Marvel, që ashtu si George, është një i mbijetuar i Holokaustit. Në përgjigje të kritikave për krahasimin, Musk shtoi se George "dëshiron të gërryjë vetë strukturën e qytetërimit tonë", një deklaratë që nxiti një kritikë ndaj miliardërit nga ana e Lidhjes Anti-Shpifje.

"Kur ata duan të fajësojnë dikë, unë jam njeriu i preferuar", - ishte kundërpërgjigja e George. Jonathan është fëmija i tretë nga martesat e parë të George me Annaliese Soros. Ai ka një vëlla dhe një motër. Prindërit e tij u ndanë kur Jonathan ishte 7 vjeç dhe babai i tij u transferua në

një apartament shumë pranë shtëpisë së familjes përballë Central Park në Nju Jork.

Ai u rrit i pasur, por George nuk ishte bërë ende një figurë financiare e njohur ndërkombëtarisht. Pas diplomimit në Universitetin Wesleyan në vitin 1992, Jonathan kaloi dy vjet duke punuar në një zyrë të re të fondacionit Soros në Budapest. Ai u bashkua fondacionit Soros në vitin 2002, pasi u diplomua për drejtësi dhe politika publike në Harvard.

Ai u bë drejtues i kompanisë pasi disa drejtues u larguan ose u zëvendësuan. Jonathan fitoi respekt nga kolegët dhe shihej si trashëgimtari i dukshëm i babait të tij. "Unë prisja që Jonathan të ishte pasardhësi i George" - thotë Aryeh Neier, president i OSF në vitet 1993-2012.

Por dallimet midis tyre e përmbysën planin e trashëgimisë. George është një njeri impulsiv. Ndërsa Jonathan është një natyrë e qetë dhe shumë analitike. Jonathan e respektonte shumë të atin, por u tërhoq nga kompania kur nuk ra dakord me vendimet e babait të tij, sipas njerëzve që punonin me ta.

Sot Jonathan jeton në Manhattan me gruan dhe tre fëmijët e tij. Sipas njerëzve përreth tyre ai dhe Alex sillen në mënyrë miqësore me njëri-tjetrin kur takohen, por nuk

kanë një marrëdhënie të ngushtë. Alex, më i madhi nga dy djemtë nga martesat e Goerge me gruan e tij të dytë, Susan Weber, dëshiron të ishte më i afërt me të atin kur rritej në fshatin luksoz Katonah në New York.

Kur ishte i ri, Alex ishte një tip i mbyllur, mbipeshë dhe ndihej i turpëruar nga pasuria e familjes së tij, tregojnë miqtë e fëmijërisë. Në adoleshencë, Alex shoqërohej ndonjëherë nga truproja ndërsa udhëtonte jashtë vendit dhe emri i familjes tërhoqi mbi të një vëmendje të padëshiruar.

Alex u afrua më shumë me babain e tij, pasi nëna e tij bëri kërkesën për divorc në vitin 2004. "Pas divorcit, im atë e mori më seriozisht prindërimin" - kujton Alex, që në atë kohë u doktorua për histori në Universitetin e Kalifornisë.

Ata kalonin orë të tëra së bashku duke diskutuar idetë dhe politikën globale. Alex nuk drejton si babai i tij. Ai ndihet shumë në siklet në mjediset të mëdha publike, thonë kolegët e tij. Dhe ai ka si pengesë mungesën relative të përvojës në skenën botërore. Por emërimi i tij mund të ndihmojë organizatën. "Gjithsesi Alex nuk ka gjasa të jetë ai që George Soros ishte për të djathtën" - thotë Romero.

Marrë me shkurtime

# Annie Fourcaut: Varfëria nuk ka asnjë lidhje, ja pse emigrantët po i vënë flakën Francës

Nga Francesca  
SALVATORE  
"Il Giornale"

Ka kaluar më shumë një javë nga fillimi i protestave të dhunshme në Francë, pas vdekjes së të riut Nahel në Nanterre. Pas ditësh dhune dhe shkatërrimi, jo pak njerëz mendonin se do të kishte një rikthim tek qetësia. Por vdekja e një 27-vjeçari në Marsejë mbrëmjen e tështunës në mesin e trazirave, rrezikon të ndezë një valë të dytë përplasjesh.

Shumë analistë dhe studiues, kanë vënë kohët e fundit në pikëpyetje gjendjen e keqe ekonomike dhe sociale të brezit të Nahel, dhe dështimin e modelit francez të asimilimit, duke mos u kënaqur me jetën në periferitë e lëna pas dore nga shteti.

Annie Fourcaut është profesoreshë e historisë bashkëkohore në Universitetin Paris 1 Panthéon-Sorbonne. Ajo është marrë shumë me studimin e konflikteve sociale dhe studimet e saj janë cituar shpesh këto ditë, në një përpjekje për të shpjeguar ngjarjet që po e tronditin Francën. Edhe pse e thekson se një historian e ka të pamundur të bëjë një analizë "në të nxehtë", ajo pranoi t'u përgjigjet disa nga pyetjet që i drejtuan.

**Sipas jush, trazirat e këtyre ditëve janë shumë të ndryshme nga ato të vitit 2005. Pse?**

Studimet e mëvonshme sociologjike, treguan se trazirat atij viti korrespondonin me zonat më të varfra të periferive të trazuara, të ndërlidhura me shkallën e lartë papunësisë dhe familjet me shumë anëtarë. Në vitin 2023 nuk ka një lidhje të tillë. Sepse janë prekur rrethinat e varfra Sevran, Grigny dhe Trappes, por edhe Nanterre dhe Montreuil, që janë në fakt periferi të pasura (Nanterre është një zgjatim i La Défense, një zone biznesi e nivelit evropian, dhe Montreuil banohet nga artistë, stilistë etj). Nanterre dhe Motreuil, cilësoheshin zakonisht si periferi të pasura dhe zakonisht të qeta. Dallimi i madh në krahasim me vitin 2005, është se këtë herë u prekën edhe qendrat e qyteteve. Ndërsa në vitin 2005 në rajonin e Parisit, rebelët nuk kaluan as unazën, as qendrën e Marsejës apo



Lionit.

Sot nuk ka më ndonjë ndryshim të madh midis qendrave të metropoleve të mëdha dhe periferive të tyre të varfra apo të pasura. Trazirat po ndodhin kudo. Edhe në qytetet me njëmadhësi mesatare dhe kryesisht të qeta: Saint Quentin në Aisne, Mons en Bareuil në veri, Marommes në Normandi etj.

Gjithsesi duhet thënë se rajonet perëndimore, ku ka pasur më pak emigracion, janë më pak të prekura. Qytetet që kanë përjetuar trazira, kanë që të gjitha përqendime të mëdha të banesave publike, dhe kjo është e vërtetë për Parisin verilindor: lagjet 18, 19 dhe 20.

Nanterre ka 52 për qind banesa publike. Ajo është një thuasje një qytet algerian. Sarcelles ka 40 ose 50 kombësi nga e gjithë bota: tamilë, kurdë, asi-ro-kaldeas, turq, aziatikë. Familjet e punonjësve francezë, me përjashtim të më të varfërve, janë zhvendosur prej kohësh në periferi, ku po i blejnë shtëpitë e tyre falë subvencioneve shtetërore.

Një ndryshim tjetër është se në vitin 2005 asnjë parti politike nuk i mbështeti rebelët, ndërsa këtë vit partia France Insoumise po e justifikon dhunën dhe trazirat. Tubimi Kombëtar i Le Pen dha një shembull të kaosit me demonstratat e Nupes. Shumica e sociologëve (jo historianëve), politikanëve, mediave publike, artistëve, kineastëve etj flasin për zhgënjimin e të rinjve të varfër emigrantë të stigmatizuar.

Kjo ishte e vërtetë në vitet 1980-1990, por nuk përputhet më me realitetin e trazirave të vitit 2023, që janë vepër e një pakice të rinjsh me origjinë emigrante, por gjithsesi shtetas francezë; që janë jashtë shkollave, të dhunshëm, dhe të integruar në mënyrë të përkryer në shoqërinë konsumatore (shih plaçkitjen e dyqaneve të markave), ndonjëherë të shoqëruar nga militantë radikalë të ekstremitë të majtë.

E majta kulturore është e përhapur gjerësisht në media, universitete, në fushën e kërkimeve shkencore dhe mediat publike, duke krijuar një atmosferë të ndjesës si shoqëri apo de-kolonializmit, që i justifikon trazirat.

**Sipas jush, varfëria nuk mjafton për të shpjeguar disa reagime. Pse?**

Një traditë e gjatë e protestave të dhunshme në Francë që nga fillimi i këtij shekulli, ka shkaktuar plaçkitje, daljen në skenë të ekstremistëve të dhunshëm (si Brigadat e Kuqe në Itali në vitet 1970) që duan të vrasin policët: kundër ligjit të punës nën kohën e Hollande, Jelekët e Verdhtë, kaosi në Stade de France kur bandat e zhveshën tifozët anglezët gjatë ndeshjes, demonstratat kundër reformës së pensioneve, apo ato kundër vaksinave, kanë degraduar që të gjitha në dhunë dhe plaçkitje të dyqaneve në qendër të qytetit ose në rrugë.

Sa për policinë, them se ajo është përgjithësisht shumë

republikane, tejet e disiplinuar, dhe vetëm një pakicë e saj është raciste. Vetëm në vitin 2022, patëm 28.000 refuzime të bindjes ndaj autoriteteve policore. Përplasjet mes të rinjve dhe policisë gjatë kontrolleve në anë të rrugës janë të vazhdueshme dhe gjithnjë të dhunshme (3 policë të vrarë në Roubaix gjatë një kontrolli rutinë, shumë policë të plagosur apo të tërhequr zvarrë me makina).

Shumë komisariate policie sulmohen rregullisht. 2023-shi është vetëm kulmi i një cikli dhune që ka zgjatuar prej të paktën 20 vjetësh. Aktivistët radikalë duan të importojnë në Francë lëvizjen "Black Lives Matter", edhe pse SHBA-ja dhe Franca kanë histori rrënjësisht të ndryshme.

Që nga viti 2005, rrjetet e drogës kanë hedhur rrënjë dhe janë përhapur në të gjithë lagjet me banesa publike, të drejtuar nga trafikantët e drogës dhe rrjetet e tyre, me armë, vrasje dhe përlëshje të vazhdueshme midis bandave. Droga ekzistonte edhe në 2005, por ishte më pak e përhapur.

Sot është kudo, dhe Marseja është ekuivalenti i Baltimorës në serialin "The Wire". Droga ka pushtuar çdo industri. Disa shkolla janë detyruar të mbyllen sepse trafikantët e drogës qëllonin njëri-tjetrin në sheshin e lojërave. E njëjta gjë ndodh në rajonin e Parisit: Saint Ouen drejtohet nga tregtarët e drogës.

Në Nanterre trafiku i drogës ka

penguar nga një program të madh të rinovimit urban. Ka shumë gjasa që ai të ketë luajtur një rol në trazirat që po shohim. Sepse sapo një program rinovimi urban prish zakonet, rrjetet e trafikantëve të drogës shkaktojnë telashe.

**A ka dështuar shteti francez me periferitë e izoluar ose siç njihen në Francë banlieues?**

Që nga viti 2003, janë investuar 40 miliardë dollarë për rinovimin urban, duke prishur ndërtesa dhe kulla, duke ndërtuar godina të vogla me shtëpi në pronësi private, për të krijuar një përzierje sociale. Ndaj s'mund të thuhet që shteti i ka braktisur këto lagje.

Po ashtu, janë bërë shumë përpjekje në shkolla dhe në sistemin arsimo. Franca është vendi i OECD me nivelin më të lartë të transfertave sociale, veçanërisht për familjet e emigrantëve që përfitojnë arsim falas, kujdesin mjekësor falas dhe mbështetje nga fondet e ndihmës sociale.

Por mbetet problemi i emigracionit të paligjshëm: vetëm në rajonin 93, supozohet se jetojnë 300-400 mijë emigrantë të paligjshëm, të cilët nuk kanë dokumente, por jetojnë në zonë dhe legalizohen gradualisht duke u transferuar më pas në banesa sociale. Shumë apartamente janë të mbipopulluara sepse janë të zëna nga disa familje, përfshirë emigrantë klandestinë që presin të pajisen më leje qëndrimi.

**Atëherë çfarë po dështon? Makronizmi apo politika e asimilimit?**

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Urim Zenelaj, besnik i Ponte Prizrenit

Prizren, 9 korrik - Urim Zenelaj vazhdon të jetë besnik i skuadrës së Ponte Prizrenit. Qendra 213 centimetra ka vazhduar kontratën edhe një sezon tjetër me prizrenasit. 32-vjeçari është pjesë e klubit nga Prizreni që nga sezoni 2018/19.

Në njoftimin për marrëveshjen e re me Zenelajn, klubi paralajmëroi se do të jetë konkurrues dhe serioz në edicionin e ri. "Prej se jemi pjesë e Superligës, Urim Zenelaj vazhdon të qëndroj besnik skuadrës. Kulla 213cm edhe për

një stinor vazhdon bashkëpunimin, po sigurisht se ai do jetë me ne edhe sezonet e ardhshme. Zenelaj pa dyshim që është qendra më e mirë vendore dhe kontributi i tij në skuadër është për tu vlerësuar. KB Prizreni pa dyshim do jetë

ekip konkurrues dhe serioz në edicionin e ri", thuhet në njoftimin e Pontes. Ponte Prizreni deri më tani ka zyrtarizuar rikthimin e Edmond Kryeziut dhe Ivan Koljeviqit, teksa është përforcuar edhe me amerikanin, Ryan Hughes.



## Dabiqaj: Transferi im bëri bujë për shkak të rivalitetit të klubeve

Transferimi i mesfushorit Albert Dabiqaj nga Gjilani te Drita bëri shumë bujë. Futbollisti në fjalë ka thënë se një gjë e tillë ndodhi për shkak se rivaliteti mes këtyre dy klubeve është i madh. "Rivaliteti i madh mes dy klubeve të qytetit ka bërë që të flitet shumë për këtë lëvizje por po e shijoj shumë pasi që pak lojtarë kanë mundësi ta përjetojnë këtë", ka thënë Dabiqaj

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Mesfushori Albert Dabiqaj ditë me parë është larguar nga skuadra e Gjilanit dhe me pas vendosi t'i bashkohet Dritës, që është rival lokal dhe historik i ish-skuadrës së Dabiqajt. Mesfushori ka thënë se ndihet i kënaqur se iu ka bashkuar klubit të Dritës. "Jam shumë i lumtur për klubin tim të ri. Të gjithë e dinë se çfarë klubi është Drita! Dua ti falënderoj drejtuesit e klubit për besimin që kanë treguar për mua edhe në

të kaluarën edhe tani. Rivaliteti i madh mes dy klubeve të qytetit ka bërë që të flitet shumë për këtë lëvizje por po e shijoj shumë pasi që pak lojtarë kanë mundësi ta përjetojnë këtë. Këtu gjeta një grup të jashtëzakonshëm të lojtarëve dhe një staf shumë profesional ku po e shijoj çdo moment me klubin", ka thënë Dabiqaj, i cili me pas falënderoi të gjitha klubet ku ka qenë pjesë e tyre, derisa ka bërë më dije se është i gatshëm të jap gjithçka për klubin e Dritës. "I jam falënderues secilit klub ku kam



punuar, por tani koha është të tifozyt 'Intelektualët', ka shtuar Dabiqaj. Mesfushori pejan ka

luajtur në të kaluarën për shumë klube përfshi, Feronikelin dhe Besën e Pejës.

### Vesel Limaj përforcon Ballkanin

Kampioni në fuqi i Kosovës, Ballkani ka bërë edhe një goditje të radhës në afatin kalimtar veror. Mesfushori Vesel Limaj është përforcimi i radhës që ka zbkruar në Suharekë. Limaj është prezantuar nga Ballkani përmes një video të publikuar në faqen zyrtare. Ai në Suharekë është transferuar nga Rumania, saktësisht nga klubi i Hermannstadt. "Edhe një kampion i bashkohet shtëpisë së kampionëve. Kemi kënaqësinë që t'u bëjmë me dije se mesfusha jonë është përforcuar me Vesel Limaj, kampion me Tiranën në Superiore e Shqipërisë e fitues i Superkupës, si dhe triumfues me Kukësin në Kupën e Shqipërisë", thuhet ndër tjerash në njoftimin e Ballkanit.

## Kosova në fund të ndeshjes pëson humbje nga Suedia

PRISHTINË, 9 KORRIK - "Dardanët" U-20 janë mposhtur nga Suedia me rezultat 84:76 (16:16, 23:24, 21:20, 24:16). Djelmohat U-20 e filluan ndeshjen shumë mirë, madje duke shkuar në pushim me një pikë dallim apo me rezultat 39:40. Edhe çereku i tretë ishte i barabartë, ku "Dardanët" po jepnin maksimumin, si në pjesën e sulmit, ashtu edhe të mbrojtje. Ndërsa çereku i fundit



ishte vendimtar ku arritëm të shënonim vetëm 16 pikë, ndërsa kundërshtari shënoi 24. Te Kosova në këtë ndeshje u dallua Bardh Istrefi me 21 pikë, si dhe Visar Ejupi me 15 pikë të tjera. Kjo ishte humbja e dytë për Kosovën U20 në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që po mbahet në Shkup të Maqedonisë Veriore. Ndeshja e ardhshme do të jetë të martën kundër Azerbajxhanit.

## 'Dardanet' U19 mposhten nga Italia

Prishtinë, 9 korrik - Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll ka humbur ndeshjen e dytë në Evropianin për hendbolliste që po zhvillohet në Prishtinë. Të dielën mbrëma, Kosova humbi nga Italia me rezultat 41:17. Vajzat e Kosovës janë munduar të japin më të mirën, por kanë bërë gabime të shumta dhe kjo kushtoi në fund. Kanë kushtuar edhe përjashtimet me dy minuta, por edhe lëshimet e shumta teknike, që vinin kryesisht nga ngutja. Italia ka luajtur ndeshjen e parë dhe ka dëshmuar se është në mesin e



favoriteve. Më tepër nga vashat "dardane" pritet në ndeshjen e së hënës mbrëma ndaj Britanisë së Madhe. Ndeshja me Britaninë zhvillohet prej orës 19:00.

## Verstappeni triumfon edhe në Silverstone

Northamptonshire, 9 korrik - Gjithçka ndodhi siç pritej, Max Verstappen është kampion dhe në Çmimin e Madh të Silverstone, duke e regjistruar kështu fitoren e gjashtë radhazi, në një edicion të

Formula 1, ku nuk duket të ketë rivalë. Pas pilotit të Red Bull, në podium u ngjiten dhe dy britanikë, Lando Norris, me McLaren, në vendin e 2-të dhe Lewis Hamilton, me Mercedes në vendin e 3-të, duke

plotësuar kështu pozicionet e medalistëve, ndërsa për skuderinë Ferrari gjithçka shkoi tmerrësisht keq, me Charles Leclerc e Carlo Sainz, që u pozicionuan në vendin e 9-të dhe të 10-të. Përsa i përket

renditjes, Verstappen vijon të marshojë drejt titullit të tretë kampion në garat e shpejtësisë. 25-vjeçari holandez kryeson kampionatin me 229 pikë, 81 më shumë se Perez i vendit të dytë.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ON Architecture” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811418187 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ON Architecture” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811418187 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “ON Architecture” L.L.Chas come to the decision to quit its business: 811418187 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- “N.T.SH. Universal AB” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330245614.
- Daut Husi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Dafina Robaj shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të mjëksisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë nga viti I, II, III, IV.
- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Valon Bilalli shpall te pavlefshme 4 dëftesa , certifikatën , diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Nexhat Meholli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “TREPÇA”.
- Belinda Aliu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.
- Leutrim Shehi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Gezim Elshani shpall të pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Erkan Gashi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Taulant Mejzini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Bekim Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Daut Rexhaj nga Gramaqel KK Decan Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Vëllaznim Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

